



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**C.nr. 683/2016**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**, gjyqtari Besnik Bisliraj, me zyrtaren ligjore Merita Xharavina, në çështjen kontestimore të paditëses K.K. per D. dhe F. me E.E. Sh.a ( në tekstin e mëturjeshëm K.), Prishtinë, të cilin e përfaqëson i autorizuari B.J.nga Gjakova, kundër të paditurit J.P., Komuna e Gjakovës, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 325.86.-€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë të datës 07.02.2018, me datë 27.02.2018 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditëses K.K. per D. dhe F. me E.E. Sh.a(K.), në Prishtinë.

**II. DETYROHET** i padituri J.P., Komuna e Gjakovës, që në emër të kompensimit të dëmit material, t'ia paguaj paditëses dëmin e shkaktuar material në shumë prej 325.86 euro dhe atë me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar prej datës së përpilimit të këtij aktgjykimi me datë 27.02.2018 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 15 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

*Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë të të paditurit J.P., Komuna e Gjakovës. në kuptim të nenit 423.4 të LPK-së.*

*Pretendimet e palëve*

Paditësja K.K. per D. dhe F. me E.E. Sh.a(K.), në Prishtinë, pranë kësaj gjykate me dt.22.12.2016, ka parashtruar padi kundër të paditurit J.G.P., Komuna e Gjakovës, për shkak të kompensimit të dëmit material në vlerë prej 162,93.-€, duke theksuar se i padituri deri me dt.16.07.2013 me qëllim që të i sjell vetit pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të pa

autorizuar , ashtu që jashtë njehsorit elektrik përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këto veprime energjia elektrike nuk është regjistruar saktë energjia elektrike, Me veprimin e tij i padituri i ka shkaktuar paditëses dëmin material në vlerë prej 162.93.-€. Gjë që është vërtetuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.440/13 të dt.28.08.2014 sipas të cilit i padituri e ka pranuar fajësinë dhe është shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK--së, përderisa e dëmtuara, tani paditësja për kompensimin e dëmit të shkaktuar në lidhje me veprën penale të lartpërmendur është udhëzuar në kontest civil.

Në shqyrtimin përgatitor i autorizuari i paditëses ka bërë rritjen e kërkesë padisë sa i përkitë lartësisë së dëmit të shkaktuar pasi që i padituri me datë 08.04.2014, ka përsëritur veprën penale dhe ka shkaktuar prapë dëme në shumë prej 162.93 euro, pasi që i njëjti është hasur në shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë të kundërligjshme, në bazë të këtyre konstatimeve ka rritur kërkesë padinë në shumë prej 325.86 euro.

I autorizuari i paditëses B.J.në shqyrtimin ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë-padisë së precizuar si dhe deklarimeve nga seancat e kaluara, dhe propozoi që sot të dëgjohet dëshmitari A.Sh., person zyrtar- punëtor pranë paditëses. Ndërkaq në fjalën përfundimtare ka theksuar se pas administrimit të provave, dëgjimin e dëshmitarit u vërtetuar në mënyrë të plotë baza dhe lartësia e kërkesë-padisë. U vërtetua se i padituri me dt.16.07.2013, dhe me dt.08.04.2014, pa njehsor elektrik përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik, duke e shpenzuar energjinë elektrike pa matje, ku në rastin e parë shkaktimi i dëmit është vërtetuar me aktgjykimin P.nr.440/13 të dt.28.08.2014, i cili ka marr formën e prerë me dt.03.02.2015. po ashtu, shkaktimi i dëmit me dt.08.04.2014, u vërtetua me procesverbalin mbi konstatimin e gjendjes faktike me nr.1120927 të dt.08.04.2014, dhe dëshmisë së dëshmitarit A.Sh., person zyrtar pranë paditëses i cili edhe e ka konstatuar keqpërdorimin. Llogaritja e dëmit është bërë në pajtueshmëri të plotë në procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike neni 14 par.3, ku dëmi është llogaritur në të dy rastet për gjashtë muaj në mënyrë retroaktive nga momenti i shkaktimit të dëmit dhe kjo shihet në faturat e bashkangjitura në këtë padi. I propozoi gjykatës që padinë dhe kërkesë-padinë ta aprovoi në tërësi në vlerën prej 325.86.-€, duke llogaritur kamatën ligjore prej 8% nga momenti i ushtrimit të padisë gjerë në pagesën definitive si dhe ta obligoi në pagesën e shpenzimeve procedurale në emër të taksave për padi shumën prej 15.00-€.

I padituri nuk ka dhënë përgjigje në padi edhe për kundër pranimin të rregullt të aktvendimit C.nr. 683/16 të datës 24.02.2017, si dhe përgjigje në ndryshimin e kërkesë padisë për kundërt pranimin të procesverbalit të seancës përgatitore në të cilën seancë i autorizuari i paditësit ka rritur kërkesë padinë nga shuma prej 162.93 euro, për dëmin e shkaktuar për datën 16.07.2013, si dhe shumën prej 162.93 euro për dëmin e shkaktuar me datë 08.04.2014, e në shumë të përgjithshme prej 325.86 euro.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar këto prova: leximin në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.440/13 të

dt.28.08.2014, leximin në faturën me numër të faturës ... të dt.29.07.2013, me numër të konsumatorit 4209 në lidhje me llogaritjen e rikthimit të humbjeve, leximin në fature nr... të dt.15.04.2014, leximi në faturën me numër të faturës ... të dt.16.04.2014. me numër të konsumatorit 4209 në lidhje me llogaritjen e rikthimit të humbjeve, leximin në procesverbal me nr.1120927 me numër të konsumatorit ... të dt.08.04.2014, shikimi në foto dokumentacionin e vendit të ngjarjes, dëgjimi i dëshmitarit A.Sh., K. e Prishtinës.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartë cekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditëses K.. Sh.a me seli në Prishtinë është **e bazuar**.

Nga leximi në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.440/13 të dt.28.08.2014, gjykata ka vërtetuar faktin se Gjykata Themelore në Gjakovë, ka shpallur fajtorë të akuzuarin J.P. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par. 1 të KPPK-së, sepse me datë të pa vërtetuar e gjer me datën 16.07.2013, në Gjakovë, me qëllim që vetit ti sjellë fitim pasuror të kundërligjor, ka shfrytëzuar në mënyrë të pa autorizuar energjinë elektrike në kundërshtim me nenin 39 të ligjit për Energjinë elektrike, direkt është furnizuar me një kabllo, duke e pamundësuar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike me ç' rast të dëmtuarës K.- Distrikti në Gjakovë, i ka shkaktuar dëme material në shumë prej 162.93 euro, gjendje kjo e konstatuar nga Komisioni i K.-it në Gjakovë, të cilit ju është shqiptuar dënimi me kusht në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve burgim i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Nga leximi në faturën me numër të faturës ... të dt.29.07.2013, me numër të konsumatorit..., në lidhje me llogaritjen e rikthimit të humbjeve, gjykata ka konstatuar se paditësja K.-i në bazë të rregulloreve të brendshme ka bërë llogaritjen e humbjeve të konsumatorit I.B., pasi që është vërtetuar se në shtëpinë e tij pronë e I.B. ishte duke jetuar i padituri J.P. kishte shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë kundër ligjore andaj rikthimi i humbjeve është llogaritur në kohëzgjatje prej 6 muajve pasi që ka të bëjë për amvisëri (shtëpi).

Nga leximi në faturën nr.... të dt.15.04.2014, leximi në faturën me numër të faturës ... të dt.16.04.2014. me numër të konsumatorit ... në lidhje me llogaritjen e rikthimit të humbjeve, gjykata ka konstatuar se paditësja K.-i në bazë të rregulloreve të brendshme ka bërë llogaritjen e humbjeve të konsumatorit I.B., pasi që është vërtetuar në bazë të procesverbalit nr. 1120927 të datës 08.04.2014, se në shtëpinë e tij pronë e Ismajl por në të cilën ka qenë duke jetuar i padituri J.P.kishte shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë kundër ligjore andaj rikthimi i humbjeve është llogaritur në kohëzgjatje prej 6 muajve pasi që ka të bëjë për amvisëri (shtëpi).

Nga leximin në procesverbal me nr.1120927 me numër të konsumatorit ... të dt.08.04.2014, gjykata ka vërtetuar faktin se zyrtarët e K.-it kanë bërë kontrollin e njehsorit të energjisë elektrike në tek shtëpia e I.B.t, në të cilën shtëpi është konstatuar se është duke jetuar J.P., numër personal..., për të cilin kanë

konstatuar se është si qiramarrës, zyrtarët e K.-it, në momentin e kontrollimit kanë konstatuar se konsumatori nuk kishte të vendosur një sor elektrik, që do të thotë ka qenë i lidhur direkt në rrjetin elektrik, e cila shihet edhe nga foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes të cilat foto janë të realizuara në shtëpinë e këtu të paditurit J. P., të cilin më pastaj e kanë shkyçur dhe sipas rregullave të të paditurës të njëjtit ju janë regjistruar edhe aparaturat, përkatësisht fuqinë hargjuese të tyre, për ti llogaritur humbjet e energjisë elektrike.

Nga dëgjimi i dëshmitarit A.Sh., K. e Prishtinës, data e lindjes..., i cili në shqyrtimin kryesorë ka deklaruar se: ka qenë viti 2014 kur kemi qenë në shtëpinë e të paditurit J.P. dhe në atë shtëpi kemi përpiluar edhe procesverbal si dhe kemi bërë fotografimin e shtëpisë së të paditurit, dhe kemi konstatuar se në momentin e kontrollës se shtëpia ka qenë direkt e lidhur në rrjetin elektrik, konsumatori ka qenë rast social me kushte të rënda ekonomike dhe i cili na ka prezantuar edhe vet dokumentacionin që vërteton një gjë të tillë si dhe objekti i tij ka qenë i vjetër siç shihet edhe në fotografi, por ne e kemi detyre dhe i kemi evidentuar të gjitha shkeljet të cilat kanë qenë në moment të kontrollës, e kemi q' kyçur kabllon nga shtylla dhe i kemi evidentuar fuqinë hargjuese të pajisjeve elektrike të cilat i ka pasur konsumatori, dhe kemi propozuar nga ekipet e K.-it që t' ia bijn njehsorin elektrik dhe t' ia vendosin në shtyllë, të cilës dëshmi gjykata ja fali besimin e plotë pasi që e njëjta ka mbështetje edhe në provat materiale që gjinden në shkresat e lëndës.

#### *Baza ligjore*

Me nenin 136 i Ligji nr. 04/1-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili parasheh që “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”, Sipas nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se “*në procedurën kontestimore gjykata më pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor, andaj në rastin konkret kemi të bëjmë me detyrimin e të paditurit i cili rrjedh në bazë të kryerjes së veprës penale, i cili është shpallur fajtor me aktgjykim të formës së prerë.*

#### *Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës*

Gjykata pas vlerësimit të të gjitha provave të lartë përmendura dhe thënieve të palës paditëse ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovohet në tërësi sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Kjo ngase në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar është provuar fakti se prej datës së pa vërtetuar e derë më 16.07.2013, në shtëpinë e marrë me qira nga pronari i shtëpisë I.B. nga Gjakova, i padituri J.P. nga Gjakova në mënyrë të kundërligjshme me fajin e ti e shfrytëzon energjinë elektrike nga ku paditësit i shkakton dëm material në shumë prej 162.93 euro, fakte që gjykata i ka vërtetuar nga aktgjykimi i lartcekur me të cilin i padituri është shpallur fajtor me të cilin është vërtetuar edhe përgjegjësia penale e tij karshi dëmit të shkaktuar ndaj të dëmtuarit- paditëses K., kopja e faturës me numër ... të dt.29.07.2013. gjithashtu nga administrimi i provave gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri nga data e pa vërtetuar e gjer me datën 08.04.2014, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të kundërligjshme, duke u kyçur direkt në rrjetin elektrik ka pasur një sor elektrik duke i shkaktuar dëme paditësit në shumë prej 162.93 euro, këto fakte gjykata i

ka vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit A.Sh. nga Gjakova, nga fatura me numër të konsumatorit nr... të dt.16.04.2014 si dhe nga foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes, andaj nga të cekurat më lartë gjykata vërteton se dëmi i shkaktuar paditëses K.-së nga këtu i padituri J.P. nga Gjakova për dy rastet e shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe atë për vitin 2013 dhe vitin 2014, të përcaktuara si më lartë është shuma e përgjithshme prej 325.86 euro.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, dhe ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së dhe atë për shpenzimet si në vijim: shumen prej 15 euro për taksën gjyqësore.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**C.nr.683/16, datë. 27.02.2018**

**Zyrtarja ligjore,**  
**Merita Xharavina**

**Gjyqtari,**  
**Besnik Bislímaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate